

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6155
E martë, 3 nëntor 2020
çmimi 0.40 €



E gjithë vëmendja te zgjedhjet në ShBA, Trump apo Biden?

FAQE 2

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATON ABDULLAHU

FAQE 4-5

PAS ZGJEDHJEVE NË SHBA, PRITET ZHBLLOKIMI I PROCESSEVE NË KOSOVË

Analisti politik Faton Abdullahu ka thënë se nga perspektiva e Kosovës nuk mund të nxjerrim një përfundim se kush i ka gjasat të fitojë tani në ShBA, Donald Trump apo Joe Biden. Ai ka bërë me dije se ai që do të jetë në krye të administratës në Uashington për katër vjetet e ardhshëm do të jetë i rëndësishëm për

të gjitha shtetet, duke përfshirë edhe Kosovën. Në këtë kontekst, ai ka thënë se Trumpi dhe Bideni nuk kanë dallime përmbajtjesore sa i takon shtetit tonë. Po ashtu, ai ka theksuar se Kosova duhet t'i ruajë raportet e mira me ShBA-në, duke kultivuar dy vlera: atë të proamerikanizimit dhe të



GJATË 24 ORËVE TË FUNDIT NË KOSOVË JANË RAPORTUAR NËNTË RASTE TË PERSONAVE TË VDEKUR NGA COVID-19 DHE 486 RASTE TË REJA ME KËTË VIRUS

SITUATA ME COVID-19 NË KOSOVË KA FILLUAR TË PËRKEQËSOHET.

FAQE 7

DEPUTETËT KËRKOJNË PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË SHQIPTARËVE NË VERI

F. 15



AKTUALE



Në 100-vjetorin e lindjes dhe në 25-vjetorin e vdekjes së plakut të urtë

ANTON ÇETTA: GJAQET PO I FALEN RINISË F. 10

PRESIDENTI THAÇI: DIALOGU KA KUPTIM VETËM NËSE VENDOSËT NË TAVOLINË NJOHJA RECIPROKE F. 3

PËRKUJTOHEN HERONJTË AFRIM ZHITIA DHE FAHRI FAZLIU

AGK-ja KËRKON NDRIÇIMIN E RASTEVE TË GAZETARËVE TË VRARË DHE TË PAGJETUR NË KOSOVË F. 6



EKONOMI

GASTRONOMËT KËRKOJNË 10 MILIONË EURO NDIHMË NGA QEVERIA F. 9

PARTNERITETI PUBLIKO-PRIVAT RRIT SIGURINË NACIONALE KIBERNETIKE F. 8

SPORT

LLAPI NDRYSHON MENDJE, VAZHDON GARAT NË SUPERLIGË F. 15

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

E gjithë vëmendja te zgjedhjet në ShBA, Trump apo Biden?

WASHINGTON, 2 NËNTOR - Me vetëm edhe një ditë deri në zgjedhje, dy kandidatët për president të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump dhe Joe Biden, po bëjnë përpjekje t'i bindin votuesit e pavendosur.

Sondazhet e opinionit e nxjerrin Bidenin përpara Trumpit në nivel kombëtar me së paku 8 për qind, por ai ka një avantazh më të ngushtë në disa shtete, që potencialisht i japin Trumpit 270 votat e nevojshme për ta fituar Kolegjin Zgjedhor, i cili e përcakton fituesin.

Një ditë para zgjedhjeve, si presidenti Donald Trump ashtu edhe sfiduesi i tij, ish-nënpresidenti Joe Biden, po argumentojnë përpara votuesve se përse e meritojnë mandatin e ardhshëm katërvjeçar në Shtëpinë e Bardhë.

Një e panjohur e madhe është pjesëmarrja në votime. Sa njerëz do të shkojnë të martën

fizikisht në qendrat e votimit, pa marrë parasysh frikën e koronavirusit, që ka lënë më shumë se 230 000 të vdekur në ShBA? Sipas organizatës Projekti Zgjedhor, deri tani kanë votuar më shumë se 93 milionë njerëz, rreth 67 për qind e të gjithë atyre që votuan në vitin 2016.

Të dyja ekipet e fushatave të kandidatëve për president pretendojnë se e shohin qartë rrugën drejt fitores. Jason Miller, këshilltar i fushatës së presidentit Trump, thotë se Trumpi e ka zgjeruar bazën e mbështetjes veçanërisht midis meshkujve afrikanë-amerikanë dhe votuesve me prejardhje latinoamerikane si dhe në shtetet që historikisht kanë qenë baza të demokratëve.

Ndërkaq demokratët thonë se rruga drejt fitores po ndryshon në favor të tyre, sepse shtetet normalisht republikane tani janë duke u kontestuar.



Dyshja Joe Biden-Kamala Harris kanë vizituar kohët e fundit shtetet Teksas, Xhorxhia dhe Ajova, të cilat në vitin 2016 mbështetën kandidatin Trump. Anita Dunn, këshilltare e

fushatës Biden, thotë se pjesëmarrja në votime do të thyejë rekorde sepse njerëzit janë të motivuar për të parë ndryshime.

Mbetet e paqartë se sa shpejt

do të jenë gati rezultatet e votimit dhe sa do të duhet të presin amerikanët për të mësuar përfundimin e këtyre zgjedhjeve, që mund të mbeten në histori.

Gjermania dhe vende të tjera të Evropës hyjnë në izolim



BERLIN, 2 NËNTOR - Gjermania nga dita e hënë ka hyrë në izolim të pjesshëm për të frenuar përhapjen e Covid-19. Numri i rasteve të reja në këtë vend u rrit të hënën për 12 097. Të dhënat e Institutit "Robert Koch" për Sëmundjet Infektive tregojnë se numri i përgjithshëm i të infektuarve në Gjermani aktualisht është 545 027.

Në 24 orët e fundit, Gjermania regjistroi edhe 49 viktima nga

Covidi, të cilat e çojnë në 10 530 numrin total të tyre. Izolimi i pjesshëm në Gjermani do të zgjasë një muaj. Belgjika, e cila po përjeton shpërthimin më të keq të Covid-19 në Evropë, po ashtu ka hyrë të hënën në izolim.

Këtë javë në izolim të pjesshëm do të hyjnë edhe Portugalia, Greqia dhe Austria.

Italia, Franca, Spanja, Çekia dhe Polonia tashmë kanë ndërmarrë

kufizime të ashpra. Numri total i të infektuarve me Covid-19 në Evropë ka kaluar tashmë 10 milionë. Në të gjithë botën, Covid-19 ka prekur mbi 46 milionë njerëz.

Prej tyre, mbi 1.2 milion kanë humbur jetën dhe mbi 31 milionë janë shëruar.

Shtetet e Bashkuara janë vendi më i prekur në botë, me mbi 9.2 milionë të infektuar dhe mbi 230 000 viktima.

Karantinohet kreu i OBSH-së

NJU JORK, 2 NËNTOR - Kreu i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), Tedros Adhanom Ghebreyesus, është karantinuar pas kontaktit me një person i cili ka rezultuar pozitiv për Covid-19. Kreu i OBSH-së thotë se nuk ka simptoma të virusit. "Unë kam qenë në kontakt me një person

që ka rezultuar pozitiv për Covid-19. Jam mirë dhe pa simptoma, por do të vetëkarantinohem, duke respektuar protokollin e vendosur për ta parandaluar përhapjen e Covid-19", ka thënë ai.

Po ashtu, Ghebreyesus u bëri thirrje qytetarëve që t'i

respektojnë rregullat e vendosura për ta mbrojtur shëndetin e tyre dhe të familjarëve. "Vetëm duke respektuar protokollin mund të ndërpriten zinxhirët e transmetimit si dhe të sigurohet mbrojtja e sistemit shëndetësor", u shpreh Ghebreyesus.



Zelanda e Re zgjedh ministren e Jashtme nga fisi indigjen

WELLINGTON, 2 NËNTOR - Zelanda e Re ka emëruar këtë të hënë ministren e saj të parë të Brendshme vendase indigjene për të përfaqësuar atë që mund të quhet një nga parlamentet më të ndryshëm në botë.

Nanaia Mahuta, e cila është Maori, populli indigjen i Zelandës së Re, katër vjet më parë gjithashtu u bë anëtarja e parë femër e parlamentit në vend që veshi një moko kauae, një tatuazh tradicional në mjekër. Ministri i mëparshëm i

Jashtëm i vendit, Winston Peters, është gjithashtu Maori. "Jam e privilegjuar që jam në gjendje të drejtoj këtë ministri", ka deklaruar Mahuta.

Partia e Laburistëve e qendrës së majtë e kryeministres Jacinda Ardern u rizgjedh në

muajin e kaluar, duke fituar 49.1 për qind të votave sipas rezultateve paraprake. Duke marrë 64 nga 120 vendet, partia e saj ishte e para që fitoi shumicën që kur sistemi aktual politik i vendit u prezantua më 1996.

Presidenti Thaçi: Dialogu ka kuptim vetëm nëse vendoset në tavolinë njohja reciproke

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të hënën se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka kuptim nëse propozimi për njohje reciproke hidhet në tavolinë përndryshe, sipas tij, është krejt i pakuptimtë, krejt i panevojshëm dhe është i dështuar

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të hënën se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, do të jetë i pakuptimtë nëse nuk e trajton çështjen e njohjes reciproke. "Kam theksuar edhe më herët,

ky dialog ka kuptim nëse propozimi për njohje reciproke hidhet në tavolinë. Përndryshe, është krejt i pakuptimtë, krejt i panevojshëm dhe është i dështuar. Kështu si po zhvillohet, është në favor të Serbisë", ka deklaruar Thaçi pasi ka bërë homazhe me rastin e 31-vjetorit të rënies së heronjve të kombit, Afrim

Zhitia dhe Fahri Fazliu.

Komente të ngjashme ka bërë të shtunën edhe kreu i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, i cili ka thënë se dialogu po e humbet kuptimin. Sipas tij, ky proces po "shndërrohet në instrument të Serbisë për të blerë kohë për t'i vënë në harresë krimet e saj. "Me sjelljet e Serbisë, në njërin anë dhe të BE-së, në anën tjetër, dialogu po e humbet kuptimin. Sa po rrjedh koha, ai më shumë po shndërrohet në instrument të Serbisë për të blerë kohë për t'i vënë në harresë krimet e saj", ka thënë Mustafa. Ai ka vlerësuar se Kosova është treguar konstruktive në këtë proces, duke shtuar se ky përkushtim

nuk është vlerësuar sa duhet nga BE-ja. "Shtrohet pyetja si konvergjon dialogu për marrëveshje gjithëpërfshirëse që rezulton me njohje reciproke me këtë zotim të qeverisë serbe. A mund BE-ja ta japë shpjegimin e saj? Kosova është treguar konstruktive karshi dialogut dhe angazhimit të BE-së dhe të ShBA-së për këtë proces. Edhe kryeministri Hoti po tregon përkushtim shumë konstruktiv. Por ky përkushtim i yni, kam përshtypje se nuk po vlerësohet nga BE-ja. Bile ka tendenca të hapen disa tema që janë të njëjta me ato që janë diskutuar në procesin e Vjenës. Ndërkaq, Kosova e ka shpallur pavarësinë me mbylljen e atyre temave në 'Pakon e Ahtisarit',

ka thënë Mustafa.

Për rrjedhën e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë dhënë kritika edhe partitë opozitare Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës.

Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e BE-së, ka nisur më 2011. Së voni, Shtetet e Bashkuara e kanë rritur angazhimin e tyre në këtë proces, për t'i ndihmuar palët për normalizimin e marrëdhënieve. Në kuadër të këtyre angazhimeve, Prishtina dhe Beogradi kanë nënshkruar marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike, më 4 shtator, në Shtëpinë e Bardhë.



Hoti kërkon nga Bosnjë Hercegovina heqjen e vizave dhe hapjen e zyrave ndërlidhëse

PRISHTINË, 2 NËNTOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka realizuar të hënën një bisedë telefonike me kryesuesin e Presidencës së Bosnjë Hercegovinës, Sefik Dzaferović. Kryeministri Hoti e ka falënderuar Dzaferovićin për nismën e tij për njohjen e Republikës së Kosovës nga Bosnjë Hercegovina,

ndërkohë që ka kërkuar vazhdimin e angazhimit të tij për heqjen sa më parë të regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës, me qëllim të realizimit të lëvizjes së lirë të njerëzve, mallrave dhe kapitalit midis të dyja vendeve.

Hoti ka shprehur gatishmërinë e Qeverisë së

Republikës së Kosovës për hapjen e Zyrave Ndërlidhëse midis të dyja vendeve si dhe thellimin e bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe të kulturës. Gjatë kësaj bisede, bashkë me kryeministrin Hoti ishin edhe zëvendësministri i Tregtisë dhe Industrisë, Cerim Bajrami dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Rasim Demiri.





Flet për "Epokën e re", Faton Abdullahu

PAS ZGJEDHJEVE NË SHBA, PRITET ZHBLLOKIMI I PROCESEVE NË KOSOVË

Analisti politik Faton Abdullahu ka thënë se nga perspektiva e Kosovës nuk mund të nxjerrim një përfundim se kush i ka gjasat të fitojë tani në ShBA, Donald Trump apo Joe Biden. Ai ka bërë me dije se ai që do të jetë në krye të Administratës në Uashington për katër vjetët e ardhshëm do të jetë e rëndësishme për të gjitha shtetet, duke përfshirë edhe

Kosovën. Në këtë kontekst, ai ka thënë se Trumpi dhe Bideni nuk kanë dallime përmbajtjesore sa i takon shtetit tonë. Abdullahu në këtë intervistë dhënë "Epokës së re" ka thënë se kur klasa politike në Kosovë do ta marrë vesh kush është në krye të administratës në Uashington do ta ketë më të lehtë për të ecur tutje. "Pas konsolidimit të ri në

Uashington, pas zgjedhjeve të 3 nëntorit, kur ta kemi presidentin e ri amerikan, tek ne pritet zhbllokimi i proceseve dhe lëvizje të reja të rëndësishme politike", ka thënë Abdullahu. Ai ka theksuar se Kosova duhet t'i ruajë raportet e mira me ShBA-në, duke kultivuar dy vlera: atë të proamerikanizimit dhe të proshqiptarizimit

- Nga perspektiva jonë nuk e kemi të lehtë të vijmë në përfundim bindës se kush do t'i fitojë zgjedhjet presidenciale në ShBA

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 2 NËNTOR - "Epoka e re": Sot (e martë) do të mbahen zgjedhjet për president të Amerikës. Kush mendon se i ka gjasat më të mëdha për fitore, Trumpi apo Bideni?

Abdullahu: Në zgjedhjet e kaluara për president në ShBA, me prognozatat tona ia kemi huq pothuajse të gjithë. Simpatia për zonjën Clinton në atë kohë na kishte mjegulluar prirjen, por edhe venitur interesimin për ta vlerësuar pragmatikisht presidentin aktual Trump, që jo

vetëm për ne në atë kohë ishte i panjohur. Konsideroj se nuk e kemi të lehtë nga perspektiva jonë, sidomos nga informacionet që i kemi, të vijmë në një përfundim bindës, bile as të përafërt, se kush i ka gjasat të fitojë tani në ShBA. Ma thotë mendja se nëse është kuptuar nga qytetarët amerikanë, ashtu siç pretendojnë republikanët se Trumpi ka filluar një rend të ri biznesor e, për rrjedhojë, edhe politik kundër Kinës (dhe atyre që e përkrahin dhe e vënë në rend të parë në raportet e tyre biznesore, këtë shtet) në të mirë të kualitetit të jetës së

qytetarëve amerikanë, atëherë Trumpi mund të fitojë. Por nëse ky rend i ri ka krijuar armiq të ri për ShBA-në, sikundër thonë demokratët, dhe nëse Trumpi me të vërtetë ka nxitur përçarje raciale, ndërmjet të bardhëve në njërin dhe të tjerëve në anën tjetër, atëherë Bideni do të jetë gjithsesi fitues.

"Epoka e re": Cila është rëndësia e këtyre zgjedhjeve për Kosovën?

Abdullahu: Se kush do të jetë në krye të Administratës në Uashington për katër vjetët e ardhshëm do të jetë e rëndësishme për të gjitha

vetëm rajonale dhe ndërkombëtare. Për sigurinë, paqen dhe demokracinë gjithandej në botë është e rëndësishme që këto zgjedhje të shkojnë korrekt dhe të jenë shprehje e vullnetit të qytetarëve amerikanë. Në këtë drejtim s'ka fakte, bile as indice, për dyshim a brengë dhe ky stabilitet është i mirë dhe duhet të çmohet. Në anën tjetër tash një kohë disa procese tek ne kanë mbetur pezull, disa të tjera edhe kanë ngecur. Procese të cilat ne tradicionalisht i koordinojmë me Uashingtonin zyrtar. Kur klasa jonë politike e merr vesh se kush është në krye të administratës në Uashington e ka më të lehtë që në bashkëpunim me presidentin e ri, me përfaqësuesit e tij, edhe të ndërmarrë hapa të ri sa për raportet me Brukselin, po aq edhe me zgjedhjet te ne, reformatimin, apo vazhdimin kështu sikundër jemi, por edhe për çështje të tjera. Pas konsolidimit të ri në Uashington, pas zgjedhjeve të 3 nëntorit kur ta kemi presidentin e ri amerikan, tek ne pritet zhblllokim i proceseve dhe lëvizje të reja të rëndësishme politike.

"Epoka e re": Gjatë fushatës zgjedhore kemi parë që liderë të

caktuar në Kosovë kanë dalë hapur në përkrahje të njërit kandidat. Ka qenë veprim i duhur ky?

Abdullahu: Z. Kurti e di që është naive dhe jopragmatike që një politikan i Kosovës të rreshtohet dhe të deklarohet haptas për këtë apo atë president amerikan në prag të zgjedhjeve atje. Por, ai e ka bërë këtë i shtrënguar nga gabimet e hershme ndaj administratës Trump, me qëllim që t'i amortizojë sulmet që po ia bëjnë tash sa kohë atij dhe subjektit të tij se janë anti-amerikanë. Pra, ndërmjet të keqes jo të vogël që prodhon rreshtimi për Trumpin apo Bidenin dhe kualifikimit ndaj tij se po e paragjykon dhe po gabon në raport me politikën e Uashingtonit zyrtar, Kurti zgjedh të parën. Kështu shpreson se së paku kualifikimi i tij për anti-amerikanizëm do të amortizohet për gjysmë nëse e përkrah Bidenin. Ai harron se sot republikanët nuk dallojnë nga demokratët ashtu sikundër dallojnë LV-ja dhe LDK-ja. Edhe kur dallojnë në disa sfera, nuk bëjnë atë që bënin LV-ja dhe LDK-ja kundër njëra-tjetrës, diçka që ai nuk e kuptoj asnjëherë drejt. Në të vërtetë Kurti, me atë që ka bërë dhe me atë që nuk ka bërë tash sa vite në raport me ShBA-në, e ka

dëshmuar se nuk di të "notojë politikisht në oqeanin euroatlantik" prirje që, për fat të mirë, e kanë të sofistikuar politikanë të tjerë në Kosovë dhe në përgjithësi të shqiptarët në Ballkan.

"Epoka e re": A mund të pritet që ShBA-ja të ndryshojë diçka në raport me Kosovën pas këtyre zgjedhjeve?

Abdullahu: Nëse lexohet me kujdes dhe vlerësohet esëll e pa emocione, ajo çfarë thotë presidenti Trump, ta zëmë në letrat e tij dërguar përfaqësuesve tanë kohë më parë dhe ajo çfarë ka thënë kandidati aktual për president, Bideni, në deklarimet e tij të fundit për Kosovën, ato nuk kanë dallime përmbajtësore, bile ato janë minore dhe krejt dytësore. Është çështje tjetër se sa do të jenë rrethanat e tjera në favorin tonë dhe sa do të jemi ne në gjendje që t'i shfrytëzojmë ato rrethana në të mirën dhe përfitimet tona. Kështu sikundër qëndron puna, e kemi të vështirë sepse e kemi një qeveri e cila punon sot për nesër, për më keq ajo, as nuk është unike, as e guximshme, as me shumicë shqiptare në të. Kjo duhet të ndryshohet nëse ne duam që të punojmë bashkë dhe të nxjerrim përfitime politike dhe të tjera në raport me presidentin e porsazgjedhur

amerikan dhe me rrethanat e reja.

"Epoka e re": Çfarë duhet të bëjë Kosova që t'i ruajë raportet me ShBA-në?

Abdullahu: Për proamerikanizmin në Kosovë duhet të angazhohemi pandalshëm si për proshqiptarizmin. Kjo nuk ka ndodhur tash sa kohë. Këto vlera, për shtetin e Kosovës, për demokratizimin dhe për lirinë tonë sot, nuk shkojnë pa njëra-tjetrën. Shqiptarizmi dhe proamerikanizmi janë bebëza të lirisë sonë në Kosovë, të identitetit tonë nacional dhe të identitetit shtetndërtues. Që t'i ruajmë raportet tona të mira me ShBA-në ne duhet, në të njëjtën kohë, t'i kultivojmë e t'i dyfishojmë funksionalisht këto dy vlera. Për më shumë ne duhet që në të njëjtën kohë të jemi - funksionalisht dhe përmbajtësisht kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në vendin tonë, selektivë dhe me ide bindëse e liberal-demokratike kundër majtizmimit ekstremist të cilin nuk po na shkon për dore as ta identifikojmë e që po na bën dëm të madh me rreshtim anti-amerikan dhe mendërisht dhe praktikisht në emër të paqes dhe sigurisë të jemi kundër islamit politik i cili është struktur, por nuk është mundur.

shtetet, për të gjitha proceset politike ekonomike dhe jo

Deputetët kërkojnë përmirësimin e kushteve të shqiptarëve në veri

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës gjatë seancës të së hënës kanë diskutuar lidhur me problemet e banorëve shqiptarë në veri të Kosovës, përkatësisht për pengesat që iu bëhen këtyre banorëve për t'u kthyer në pronat e veta dhe për problemet për renovimin e shtëpive të djegura që nga përfundimi i luftës.

Deputetët kanë diskutuar edhe për çështjen për blerjen e pronave të shqiptarëve nga serbët me, siç u tha, "ndihmën e Qeverisë së Serbisë". Deputetja Valdete Idrizi nga Partia Demokratike e Kosovës, e cila vjen nga Mitrovica e Veriut, ka thënë se shqiptarët në veri të Kosovës, nga presioni dhe varfëria, i kanë shitur dhe po shesin pronat e tyre.

Ajo ka theksuar se shqiptarëve, të cilët kanë pronat e tyre ende në veri, nuk u lejohet qasja në to. "Rrënimet e shtëpive të shqiptarëve akoma janë të dukshme dhe pritet të ndërtohen ndërtesa shumëkatëshe. Aktualisht në disa lagje janë duke u ndërtuar edhe disa ndërtesa. Vetëm në këtë vit janë ndërtuar rreth 10 ndërtesa shumëkatëshe për serbët. Projekti madhor 'Lugina e Diellit', një lagje e tërë është në përfundim e sipër, ku do të vendoset vetëm popullatë e



nacionalitetit serb", është shprehur Idrizi. Sipas saj, në veri të Kosovës po ndodh një kolonizim i ri.

Në Zveçan, komunë e banuar me shumicë serbe në veri të Kosovës, në një sipërfaqe prej 15 hektarësh, Serbia dhe Kisha Ortodokse Serbe janë duke e përfunduar ndërtimin e 300 një-sive banesore në kuadër të vendbanimit "Lugina e Diellit". Këto njësi banesore janë të destinuara për personat e zhvendosur nga Kosova, të komunitetit serb.

Lidhur me ndërtimin e vendbanimit, që ka vlerën e rreth 14 milionë eurove, shefi i Grupit Parlamentar i Lëvizjes

Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka deklaruar se në veri të Kosovës po bëhet një spastrim i dhunshëm i shqiptarëve nga serbët. "Gjithë situata e krijuar me dëbimin e dhunshëm dhe në kuadër të të njëjtit qëllim edhe me formimin e Zajednicës [Asociacionit], kanë qëllim spastrimin etnik kundër shqiptarëve nga vendbanimet e tyre dhe kolonizimin e tyre me kolonë të ardhur nga përtej Kosovës", ka thënë Selimi.

Ai ka shtuar se shqiptarët të cilët janë duke jetuar në veri të Kosovës janë duke jetuar me një sakrificë e rrezik të madh, pa u mbështetur nga shteti.

Deputetët thanë se në veri të Kosovës banorët shqiptarë, por edhe të komuniteteve të tjera si ata boshnjakë, turq e romë, përballen me shkelje të mëdha të të drejtave të njeriut.

Saranda Musliu, deputete nga Lidhja Demokratike e Kosovës, ka pohuar se në komunat e veriut të Kosovës banorët shqiptarë jetojnë në kushte të vështira dhe përballen çdo ditë me diskriminim dhe probleme të shumta. "Nuk jemi kundër që atje lagjet të popullohen, por duhet të ketë barazi. Prandaj na duhet një strategji urgjente dhe unifikim i faktorit politik për të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm", ka thënë ajo.

Kurse deputetja Time Kadriaj nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka theksuar se gjendja e shqiptarëve në veri të Kosovës nuk është e mirë. Sipas saj, institucionet e Kosovës duhet të ndërmarrin veprime për ta ndryshuar gjendjen në atë pjesë të Kosovës. "Është e papranueshme që këta njerëz sot të paguajnë qira vetëm disa kilometra larg nga shtëpitë e tyre në Mitrovicën e Jugut e tokat e pronat e tyre t'i shfrytëzojnë pa të drejtë serbët e veriut", ka thënë Kadriaj.

Deputeti nga Lista Serbe, Igor Simiq, duke folur për këtë çështje, tha se në shumë qytete të Kosovës kanë jetuar serbë por tash, siç tha ai, "nuk jetojnë më në ato vende". "Ju keni kërkuar një debat, por a e pyetni veten se ku janë serbët që kanë jetuar në Vushtrri, Prishtinë dhe në qytete të tjera? Veriut është një mjedis urban shumëtnik dhe unë jam krenar sepse jam deputet që vij nga kjo anë. Atje jetojnë turqit, shqiptarët, serbët dhe të tjerët", ka deklaruar Simiq.

Pas kësaj fjale, deputeti nga Lëvizja Vetëvendosje, Arbër Rexhaj, i ka thënë deputetit Igor Simiq nga Lista Serbe, se Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë dhe nuk ka kërkuar falje.

Borxhet e veriut të Kosovës

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Qytetarët që jetojnë në katër komunat në veri të Kosovës me shumicë serbe (Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq), që nga përfundimi i luftës më 1999 vazhdojnë të mos paguajnë faturat e energjisë elektrike, ujit të shpenzuar, por në raste të shumta as obligimet tatimore ndaj shtetit të Kosovës.

Rreth 12 milionë euro në vit llogaritet fatura e përbashkët e energjisë së shpenzuar në këto komuna. Që nga viti 1999 deri në vitin 2017, këto mjete janë paguar nga konsumatorët e viseve të tjera të Kosovës. Faturat e qytetarëve të Kosovës ishin për 3.5 për qind më të shtrenjta, vlerë kjo që konsiderohet se është paguar për qytetarët e pjesës veriore të Kosovës. Por, pas ankesave të shumta, Gjykata e Apelit, në fund të vitit 2017, kishte vendosur që kjo praktikë të pezullohet, sepse ishte joligjore.

Rrymën e shpenzojnë, por fatura nuk paguajnë

Edhe gjatë vitit të kaluar qytetarët e kësaj pjese nuk kanë paguar faturat e energjisë. Në raportin vjetor të vitit 2019, të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, nuk janë llogaritur humbjet me mjete financiare, por thuhet se "konsumi i paautorizuar i energjisë përbën 13.04 për qind të kërkesës në shpërndarje, prej së cilës energjia e pafaturuar në katër komunat veriore të Kosovës përbën 5.53 për qind ose 294 Gigavatorë (GWh)". Konsumatorët e kësaj pjese furnizohen me energjinë e prodhuar nga termocentralet e Korporatës Energjetike të

Kosovës (KEK), kurse faturat duhet t'ia paguajnë Distribucionit të Furnizimit me Energji Elektrike (KEDS), pasi kjo e fundit ka privatizuar rrjetin e shpërndarjes së energjisë.

Mospagesa e faturave ka ndodhur për shkak se zyrtarë të sektorit të energjisë e kishin të pamundur qasjen në veri të Kosovës dhe nuk arritën t'i lexojnë njehsorët, t'ua dërgojnë faturat qytetarëve dhe as t'i mbledhnin të hyrat për energjinë e shpenzuar atje.

Katër komunat në veri të Kosovës janë të banuara me shumicë serbe, të cilat ndër vite kanë funksionuar jashtë sistemit juridik-kushtetues të Kosovës.

Në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, qysh në vitin 2013 ishte nënshkruar Marrëveshja për Energji por që, si e tillë, nuk është zbatuar nga Serbia.

Në bazë të Marrëveshjes për Energji, të arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, kusht për Serbinë ishte edhe regjistrimi i një kompanie të re serbe sipas kornizës ligjore të Kosovës, e cila do t'i furnizojë me energji konsumatorët në katër komunat veriore me shumicë serbe.

Autoritetet kompetente të Kosovës kanë plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet për regjistrimin e kësaj kompanie, por që Serbia nuk po e bën një veprim të tillë.

Në veri nuk paguajnë as për ujin e shpenzuar

Përveç 12 milionë eurove në vit për faturat e energjisë, konsumatorët e këtyre



komunave kanë borxh edhe mbi 15 milionë euro të tjera për faturat e ujit të shpenzuar që nga viti 1999. Konsumatorët e këtyre komunave furnizohen me ujë të pijshëm nga Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica". Kjo kompani është nën ombrellën e Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit (ARRU).

Zyrtarë të këtij autoriteti më herët kanë thënë për "Radion Evropa e Lirë" se në pjesën veriore gjatë vitit 2019 janë dërguar mbi 6 milionë metër kub ujë. Madje çmimi për një metër kub në atë pjesë kushton 0,17 euro, kurse për konsumatorët e pjesës jugore është rreth dyfish më i lartë. Mospagesa e faturave jo rrallëherë ka vështirësuar veprimtarinë e kompanisë. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës pothuajse për çdo vit bën subvencionim në shumata të

ndryshme financiare, në mënyrë që të mundësohet operimi i kompanisë. Subvencionimi i qeverisë për kompaninë e ujësjellësit "Mitrovica" ka ndodhur me taksa të tatimpaguesve.

Veriu i Kosovës edhe pa kuponë fiskalë

Në atë pjesë bizneset zhvillojnë veprimtarinë e tyre në shumicën e rasteve të pargjistruara në institucionet qendrore të Kosovës dhe pa paguar obligimet tatimore. Në katër komunat e banuara me shumicë serbe në pjesën veriore të Kosovës, në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) janë të regjistruara vetëm 981 biznese me gjithsej 1 316 njësi aktive. Nga ky numër, tatim në ATK paguajnë 255 biznese. Nga muaji janar deri në muajin

shtator të këtij viti, vlera e tatimeve të marra nga këto biznese, pa kontribute pensionale, është 663 mijë euro, kanë thënë për "Radion Evropa e Lirë", zyrtarë të ATK-së. Bizneset në atë pjesë operojnë edhe pa Pajisje Elektronike Fiskale, proces ky që në gjithë territorin e Kosovës ka filluar në vitin 2009. Në bazë të kësaj pajisjeje, pas çdo blerjeje lëshohet kuponë fiskal. Moslëshimi i kuponit fiskal dhe mostransmetimi i të dhënave në Administratën Tatimore të Kosovës janë të ndëshkueshme me ligjet në fuqi. Zyrtarë të Administratës Tatimore të Kosovës kanë thënë për "Radion Evropa e Lirë" se qasja e këtij institucioni në katër komunat e banuara me shumicë serbe nuk është shumë komode nëse krahasohet me rajonet e tjera të Kosovës.

Përkujtohen heronjtë Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu



PRISHTINË, 2 NËNTOR (ER) - Presidenti Hashim Thaçi, kryeministri Avdullah Hoti dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, kanë bërë homazhe të hënën te varret e heronjve Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, me rastin e 31-vjetorit të rënies së tyre. "Sot, bashkë me disa anëtarë të kabinetit, bashkëlufëtare dhe familjarë të dy heronjve, bëmë nderimet në përvjetorin e rënies së tyre. Edhe pse në kushte pandemie e me rregulla strikte, prania e të gjithëve sot tregon për respektin që gjithë Kosova ka për heronjtë që sakrifkuan jetën e tyre, për lirinë që ne e gëzojmë sot", ka thënë kryeministri Avdullah Hoti. Ndërkaq kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush

Haradinaj, ka thënë se 2 nëntori është ditë e vetëdijes kombëtare, por edhe e pozicionimit për t'i shërbyer lirisë që është arritur. Edhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka përkujtuar heronjtë Fahri Fazliu dhe Afrim Zhitia. Veseli ka thënë se me punën e tyre Fahriu dhe Afrimi kanë përgatitur breza veprimtarësh të rinj të kauzës kombëtare. "Krismat e pushkëve të Fahriut dhe Afrimit ishin paralajmërim i pushkës së vajzave dhe djemve të UÇK-së që do ta sillnin lirinë një dekadë më vonë. Edhe për ne, aktivistët e rinj ilegalë të asaj kohe, ky akt shërbeu si obligim për të mos u ndalur në rrugën tonë për liri. Jam krenar që kam qenë shok dhe bashkëveprimtar i Fahriut dhe Afrimit!", ka thënë Veseli.

Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë janë raportuar nëntë raste të personave të vdekur nga Covid-19 dhe 486 raste të reja me këtë virus

Situata me Covid-19 në Kosovë ka filluar të përkeqësohet

Kosovës të hënën i janë shtuar 486 raste të reja me Covid-19, pas marrjes së 1 374 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar nëntë viktima. Sipas të dhënave të këtij Instituti, të hënën janë regjistruar edhe 30 raste që kanë mposhtur virusin, kurse raste aktive aktualisht janë 4 317. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, dhe drejtori i IKShPK-së, Naser Ramadani, vlerësuan se situata epidemiologjike me Covid 19 në vendin tonë është serioze dhe me tendenca përkeqësimi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 374 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 486 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar nëntë raste të personave të vdekur nga ky virus.

Numri total i rasteve pozitive është 20 655 raste nga 97 148 persona të dyshimtë me Covid-

19 dhe 697 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 30 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 15 641 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 4 317.

Rastet e fundit pozitive janë nga: Komuna Prishtinë 165 raste, Komuna Gjilan 79 raste, Komuna Prizren 32 raste, Komuna Podujevë 31 raste, Komuna Fushë-Kosovë 27 raste, Komuna Ferizaj 23 raste, Komuna Pejë 21 raste, Komuna Gjakovë 17 raste, Komuna Viti 13 raste, Komuna Shtime 11 raste, Komuna Suharekë 10 raste, Komuna Vushtrri 10 raste, Komuna Kamenicë 9 raste, Komuna Lipjan 6 raste, Komuna Obiliq 6 raste, Komuna Deçan 5 raste, Komuna Drenas 4 raste, Komuna

Rahovec 4 raste, Komuna Klinë 3 raste, Komuna Mitrovicë 3 raste dhe me nga një rast Komunat Hani i Elezit, Istog, Junik, Kaçanik, Malishevë, Novobërdë dhe Skenderaj.

Në takimin e rregullt javor midis përfaqësuesit të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, me partnerët ndërkombëtarë (misionet diplomatike, Komisioni Evropian, agjencitë e OKB-së në Kosovë) u diskutua për masat e reja të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së

Kosovës për menaxhim të epidemisë me Covid-19.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, dhe drejtori i IKShPK-së, Naser Ramadani, vlerësuan se situata epidemiologjike me Covid 19 në vendin tonë është serioze dhe me tendenca të përkeqësimit. Pasi që numri i qytetarëve të prekur me Covid-19 në ditët e fundit arrin 120 të infektuar në 100 mijë banorë, MSh-ja dhe IKShPK-ja, të cilat po përcjellin situatën dhe zbatimin e masave, nëse do të jetë e nevojshme, do të rekomandojnë dhe do të ndërmarrin veprime shtesë për ta mbrojtur shëndetin publik të qytetarëve të Republikës së

Kosovës.

Partnerët ndërkombëtarë shprehën mbështetjen e plotë për masat e ndërmarra nga ana e qeverisë si dhe kërkuan angazhim shtesë për monitorimin e situatës. Sipas tyre, nëse do të jetë e nevojshme nuk duhet të përjashtohet edhe ashpërsimi i masave, për ta vënë nën kontroll shpërndarjen e virusit dhe mirëmbajtjen e sistemit shëndetësor. Të gjitha palët u pajtuan që të shtojnë komunikimin me qëllim të rishikimit të gjendjes epidemiologjike dhe në rast nevojë të ndërmarrjes së masave të nevojshme në përputhje me situatat e krijuara.

AGK-ja kërkon ndriçimin e rasteve të gazetarëve të vrarë dhe të pagjetur në Kosovë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) ka kërkuar ndriçimin e rasteve të gazetarëve të vrarë dhe të pagjetur në Kosovë. Në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Mosndëshkimit për Krime ndaj Gazetarëve, AGK-ja ka bërë thirrje që autorët e krimeve ndaj gazetarëve të dalin para drejtësisë dhe ta marrin dënimin e merituar. Mosndëshkimi i krimeve të kryera ndaj gazetarëve është sinjal i keq për sundimin e rendit dhe të ligjit në Kosovë dhe barrë që rëndon në vazhdimësi mbi familjet e viktimitave dhe komunitetin e gazetarëve që prej vitesh kërkojnë drejtësi. Kjo klimë e pandëshkueshmërisë ndikon në lirinë e raportimit dhe inkurajon që në të ardhmen të ndodhin sulme dhe kërcënime të tjera. Kryetarja e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Gentiana Begolli-Pustina, ka ftuar organizatat ndërkombëtare që të

ndihmojnë për krijimin e një fondi të veçantë për hulumtimet e gazetarëve për hetimin dhe ndriçimin e rasteve të kolegëve tanë të vrarë dhe të pagjetur. "Për mua jo vetëm si kryetare e AGK-së, jo vetëm si gazetare, por pikë së pari si njeri është më se e rëndësishme që jo vetëm kryerësit, por edhe urdhërdhënësit e këtyre krimeve të dalin para drejtësisë. Edhe më herët e kam thënë se mua si përfaqësuese e gazetarëve nuk më intereson as edhe një çast se çfarë etnie ka vrasësi, çfarë religjioni mund të ketë, çfarë funksioni mund të kenë urdhërdhënësit e vrasjeve, për mua e rëndësishme është t'i shoh aty ku e kanë vendin, bashkë me kriminelët e tjerë. Këtë e presim të gjithë, sikurse familjarët ashtu edhe ne gazetarët dhe të gjithë ata që po punojnë çdo ditë, për një shtet të së drejtës ku mbizotërojnë rendi dhe ligji", u shpreh Begolli-Pustina.

Sipas AGK-së, 12 gazetarë janë vrarë gjatë dhe pas luftës në



Kosovë dhe katër gazetarë raportohen si të pagjetur. Hetimi i këtyre rasteve ka qenë përgjegjësi e UNMIK-ut (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë) e më pas i EULEX-it (Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Rendit dhe të Ligjit), ndërsa që nga marsi i vitit 2017, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumnezi, ka caktuar një prokuror-koordinator për rastet e kanosjeve apo veprave të

tjera penale në drejtim të gazetarëve.

Në vitin 2018 Federata Evropiane e Gazetarëve, në takimin vjetor në Lisbonë, ka miratuar një rezolutë përmes së cilës kërkohet hetimi i vrasjeve dhe zhdukjeve të gazetarëve në periudhën 1998-2005 dhe kompensimi i familjeve të viktimitave. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka shpallur 2 Nëntorin,

Ditën Ndërkombëtare për Përfundimin e Mosndëshkimit të Krimeve ndaj Gazetarëve, duke iu bërë thirrje shteteve anëtare që të zbatojnë masa që ta luftojnë kulturën aktuale të mosndëshkimit. Në këtë ditë bëhet fushatë globale përmes së cilës kërkohet nga institucionet shtetërore që ta parandalojnë dhunën në drejtim të gazetarëve.

Për tre muaj u regjistruan 2 593 ndërmarrje, më shumë se në vitin 2019

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar repertorin statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë për tremujorin e tretë të këtij viti, ku thuhet se në tremujorin e tretë të vitit 2020 gjithsej janë regjistruar 2 593 ndërmarrje. Krahasuar me tremujorin paraprak, ka rritje për 27.54 për qind të ndërmarrjeve të regjistruara. Ndërsa krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM3 2019), ka rritje për 8.9 për qind të ndërmarrjeve të regjistruara. Sipas ASK-së, sa i përket aktiviteteve ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori ishin: Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 597 ndërmarrje të regjistruara 23.02 për qind, prodhimi me 302 ndërmarrje të regjistruara 11.65 për qind, akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim me 282 ndërmarrje të regjistruara 10.88

për qind, bujqësia, pylltaria dhe peshkataria me 257 ndërmarrje të regjistruara 9.91 për qind, aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 235 ndërmarrje të regjistruara 9.06 për qind, ndërtimtaria me 231 ndërmarrje të regjistruara 8.91 për qind etj. Gjatë këtij tremujori, në kategorinë me 1 deri në 4 të punësuar ishin gjithsej 1 511 ndërmarrje të regjistruara (96.8 për qind); në kategorinë me 5 deri 9 të punësuar ishin 51 sosh (2 për qind); në kategorinë me 10 deri në 19 të punësuar ishin 24 ndërmarrje të regjistruara (0.9 për qind); në kategorinë me 20 deri 249 të punësuar ishin 7 ndërmarrje të regjistruara (0.3 për qind); ndërsa në kategorinë me 250 e më shumë të punësuar, nuk ka ndonjë ndërmarrje të regjistruar. "Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të komunave, ashtu si në çdo tremujor mbizotëron Komuna e Prishtinës me 771 ndërmarrje të regjistruara (29.7 për qind);



Prizreni me 197 ndërmarrje të regjistruara (7.6 për qind); Ferizaj me 186 ndërmarrje të regjistruara (7.2 për qind); Peja me 141 ndërmarrje të

regjistruara (5.4 për qind); Gjilani me 129 ndërmarrje të regjistruara (5 për qind); dhe Gjakova me 114 ndërmarrje të regjistruara (4.4 për qind).

Ndërsa komunat e tjera kanë numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara në këtë tremujor", thuhet në njoftimin e ASK-së.

Kuçi nënshkruan dy memorandume në Samitin Digjital të Ballkanit Perëndimor

PRISHTINË, 2 NËNTOR (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka përfaqësuar Kosovën në Samitin Digjital të Ballkanit Perëndimor, i cili këtë vit është mbajtur në Tiranë, nismë e cila realizohet në kuadër të Procesit të Berlinit dhe Planit Shumëvjeçar të Veprimit të Zonës Rajonale Ekonomike. Samiti është hapur nga komisionarët e Bashkimit Evropian, Thierry Bretton dhe Mariya Gabriel, sekretarja e RCC-së, Majlinda Bregu dhe kryeministri shqiptar Edi Rama. Në këtë samit, përveç fjalimeve të ministrave, janë nënshkruar edhe dy memorandume mes gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor: Memorandumi i



mirëkuptimit për udhërrëfyesin e 5G për transformimin digjital në rajonin e Ballkanit Perëndimor si dhe memorandumi i mirëkuptimit për Interoperabilitetin dhe shërbimet e besimit rajonal në

rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ministri Blerim Kuçi në këtë samit ka folur për punët që po bëhen Qeveria e Kosovës për të qëndruar në hap me botën teknologjike në aspektin e infrastrukturës dhe të hapësirës

së krijuar nga institucionet. "Ne e mbështesim Agjendën Digjitale për Ballkanin Perëndimor dhe duke shfrytëzuar momentin e imponuar nga kriza Covid-19, mendojmë se bashkërisht mund të gjejmë zgjidhje që nëpërmjet TIK-ut të tejkalohen elementet e caktuara të krizës që njëkohësisht do të kenë ndikim në transformimin digjital", ka thënë ministri Kuçi.

Ajo që Kosova realisht ka arritur në këtë sektor dhe që ministri Kuçi i prezantoi para homologëve rajonalë dhe komisionarëve evropianë janë: mbulimi deri në fund të vitit 2020 të të gjitha zonave të bardha me fibër optik, krijimi i

Zyrës së Kompetencës për Broadband, Rrjetin Nacional për Hulumtim dhe Edukim që do të integrohet në rrjetin Pan-Evropian GEANT, Atlasin elektronik brezgjere për infrastrukturën, shërbimet dhe investimet në rrjetet e komunikimeve elektronike, avancim në 5G dhe memorandumet e nënshkruara për autostradën 5G, krijimin e Parkut të Teknologjisë Digjitale në Prishtinë dhe Qendrën e Ekselencës Digjitale në Prizren. Në margjinat të takimit, ministri Kuçi shfrytëzoi rastin të takohet edhe me delegacionet e vendeve fqinje, duke folur për bashkëpunimet bilaterale dhe shkëmbimin e përvojave të mira.

Çmimi i naftës, rënie rekord pas izolimit

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Çmimi i naftës shënoi një rënie rekord në pesë muajt e fundit të hënën, pas izolimeve të reja të vendosura në disa vende të botës për shkak të Covid-19. Shumë ekonomi kanë forcuar kufizimet përfshirë Britaninë, Francën dhe Gjermaninë, ndërsa përballen me një shkallë të shtuar infektimesh. Frika është se masat e reja të izolimit do të dëmtojnë më shumë rritjen ekonomike dhe kërkesa për naftë do të bjerë. Ndërkohë tregjet janë të shqetësuara edhe për ecurinë e

zgjedhjeve në ShBA. Në bursat aziatike, çmimi i naftës bruto, Brent, ra në 35.74 dollarë për fuçi, një nivel ky që nuk regjistrohej që nga maji i vonë. Çmimi i naftës Brent është një tregues për çmimin e naftës në përgjithësi dhe është 45 për qind më i ulët krahasuar me fillimin e vitit. Situata e lidhur me pandeminë ka rënduar shumë edhe mbi kompanitë e energjetikës me British Petroleum dhe Shell që kanë njoftuar reduktimin e mijëra vendeve të punës këtë vit.



Partneriteti publiko-privat rrit sigurinë nacionale kibernetike



**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Avancimi digjital i përshpejtuar nga pandemia Covid-19 ka sjellë përfitime të ndryshme për shoqërinë, në të njëjtën kohë u ka hapur rrugë rreziqeve të padukshme kibernetike. Gjatë një forumi virtual të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë me një panel ekspertësh vendorë dhe të huaj, u diskutua epoka e re e sigurisë kibernetike, mbështetja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme rreth sigurisë kibernetike, si dhe rëndësia e partneritetit publiko-privat dhe e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë aspekt.

Xhavit Gashi, këshilltar i jashtëm i Odës Ekonomike Amerikane, njëherësh edhe moderator i kësaj ngjarje, ka thënë se situata globale e krijuar nga pandemia Covid-19 e ka rritur rëndësinë e sigurisë

kibernetike, gjithashtu edhe numrin e rreziqeve që burojnë nga ajo.

Gjenerali Timothy Orr, ish-drejtor për mbrojtje publike në shtetin e Iowas, ka theksuar se në Shtetet e Bashkuara gjerësisht përdoret partneriteti publiko-privat për ta mbrojtur infrastrukturën kritike dhe rrjetet, si dhe për ta shtyrë strategjinë e përgjithshme kibernetike. Sipas tij, çdo qeveri duhet të ketë një strategji kibernetike me të cilën përcaktohet funksionimi i vendit në këtë aspekt, duke krijuar një kornizë për ndarjen e informatave mbi rreziqet kibernetike që iu kanosen sektorit publik dhe atij privat.

Doug Jacobson, profesor dhe drejtues i Qendrës për Siguri të Informacionit në Universitetin Shtetëror të Iowas, ka deklaruar se rëndësi e veçantë në këtë vend po i kushtohet edukimit të shoqërisë mbi sigurinë kibernetike. Sipas

Jacobsonit, gjatë kësaj periudhe të përdorimit edhe më të madh të digjitalizimit janë parë shumë praktika mashtruese, siç janë ato të dërgimit të e-maileve të rreme me qëllim të zbulimit të informacioneve personale, të cilat kryesisht targetojnë individët, por edhe të tjera më serioze me target bizneset.

Lajos Antal, udhëheqës për shërbimet e rrezikut kibernetik në Evropën Qendrore brenda kompanisë "Deloitte", ka theksuar se sulmet kibernetike të cilat në nivel global kanë qenë në rritje gjatë kësaj kohe, përveçse dëmtojnë financiarisht kompanitë, dëmtojnë edhe marrëdhëniet me partnerët, shitësit e besueshëm dhe aktorët e tjerë. Sipas tij, siguria kibernetike kërkon investime, megjithatë është e pashmangshme dhe luan rol në mbrojtjen nga sulmet të cilat sulmojnë kompanitë.

Kujtim Gashi, drejtor i

përgjithshëm i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, ka deklaruar se kjo kohë ka krijuar një mundësi të mirë për sinkronizim të aktiviteteve lidhur me sigurinë kibernetike në mes të sektorit publik dhe atij privat. Sipas tij, është shumë e rëndësishme që në vitet e fundit janë rritur kapacitetet e sigurisë kibernetike në infrastrukturën shtetërore dhe sulmet deri më tani janë përballuar me sukses.

Xhanan Karaqa, udhëheqëse e Departamentit të Sigurisë në NLB Bank, ka potencuar se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë ballafaquar me sulme kibernetike të cilat janë të pranishme në çdo shtet të botës, ndërsa ka theksuar rëndësinë e rritjes së njohurive të këto ndërmarrje lidhur me rreziqet kibernetike, në mënyrë që të njëjtat të kenë mundësi t'i mbrojnë rrjetet dhe të dhënat e tyre.

Ndërkaq Rina Basholli, inxhinieri

e avancuar në sigurinë e informacionit, ka theksuar se tashmë me një avancim të përshpejtuar nga pandemia, mundësitë e rritura për sulme kibernetike kanë prekur sektorë të ndryshëm të sigurisë. Sipas saj, mungesa e njohurive për sigurinë kibernetike mbetet një sfidë, derisa ekziston nevoja për ngritje të ndërgjegjësimit të shoqëria ndaj sulmeve të mundshme dhe nevojës për të qenë pro-aktiv në këtë aspekt.

Mentor Hoxhaj, kryetar i Cyber Security and Privacy, ka pohuar se një ndër problemet kryesore lidhur me sigurinë kibernetike është mungesa e raportimit të shkeljeve në të dhëna dhe mungesa e investimeve në një infrastrukturë kibernetike. Hoxha, gjithashtu, ka theksuar nevojën për krijimin e një standardi për raportim dhe rritjen e transparencës në mënyrë që të hartohen sistemet mbrojtëse.

Gastronomët kërkojnë 10 milionë euro ndihmë nga qeveria

PRISHTINË, 2 NËNTOR (ER) - Shoqata e Gastronomëve e Kosovës (ShGK) ka kërkuar pako të veçantë ekonomike nga Qeveria e Kosovës, në të kundërtën kjo shoqatë ka paralajmëruar se nuk do t'i ndalë aksionet për të kërkuar mbështetje financiare. Kryetari i kësaj shoqate, Petrit Kllloqi, ka deklaruar se gastronomia është ndër sektorët më të prekur nga pandemia, pasi një numër i madh i bizneseve janë mbyllur. "Nëse nuk përkrahet me ndonjë pako sektori i gastronomisë, aksionet nuk do të ndalen dhe ne paralajmërojmë masa të tjera sepse jemi dëmtuar shumë dhe stafin tonë që do ta largojmë nga puna, do ta dërgojmë para

qeverisë", ka thënë Kllloqi. Ndërsa kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka deklaruar se kërkesa është që për sektorin e gastronomisë të ofrohen 10 milionë euro ndihmë nga qeveria. "Sektori i gastronomisë ka qenë më i ndikuar negativisht nga pandemia dhe, siç po e shihni, në qytet ka më pak qarkullim të njerëzve dhe automatikisht ka rënë konsumi. Ne kemi rënë dakord që të kërkojmë pako të veçantë për sektorin e gastronomisë. Ia kam dërguar një letër kryeministrit Hoti, ku kam kërkuar që bizneset që po ballafaqohen me kufizime të përkrahen siç janë përkrahur më herët", ka deklaruar Rukiqi.





NË 100-VJETORIN E LINDJES DHE NË 25-VJETORIN E VDEKJES SË PLAKUT TË URTË

ANTON ÇETTA: GJAQET PO I FALEN RINISË

Anton Çetta lindi më 3 janar 1920 në Gjakovë. Shkollën e mesme e kreu në Liceun e Korçës. Në vitin shkollor 1945-1946 punoi në Gjimnazin e Prizrenit. Në vjeshtën e vitit 1946 u regjistrua në Fakultetin e Filologjisë, Dega e Gjuhës Frënge, në Universitetin e Beogradit. Studimet i kreu në vitin 1950, ku edhe u emërua asistent në Seminarin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, që funksiononte në kuadër të Fakultetit të Filologjisë të këtij universiteti. Në vitin 1961, kur në Prishtinë u hap Fakulteti Filozofik, emërohet mësimmhënës i gjuhës dhe letërsisë shqipe, ku ligjëron lëndën e letërsisë së vjetër.

Nga viti 1968, ka qenë udhëheqës i Departamentit të Folklorit në Institutin Albanologjik të Prishtinës.

Anton Çetta botoi 16 libra me përmbledhje folklori dhe traditë gojore.

Në vitin 1990 profesor Anton Çetta i është bashkangjitur pajtimit të gjaqeve, të filluar nga të rinjtë studentë, ish të burgosur politikë, Myrvete Dreshaj, Have Shala, Adem Grabovci, Lulëzim Etemaj dhe Brahim Dreshaj. Gjatë periudhës njëvjeçare të veprimtarisë së Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve, Plagëve dhe Ngatërresave në Kosovë 1990-1991 u falën 1 169 gjaqe, 477 plagë, 865 ngatërresa. Plaku i urtë Anton Çetta ishte një nga shtyllat kryesore të saj.

Në shenjë kujtimi ndaj tij, në 100-vjetorin e lindjes dhe në 25-vjetorin e vdekjes, për lexuesit e gazetës "Epoka e re" po e sjellim intervistën që profesor Anton Çetta i ka dhënë gazetës "Zëri i rinisë", të datës 7 prill 1990, faqe 17-19.

Një grup të rinjsh me një profesor, me një burrë, me një pleqnar... pastaj erdhën profesorë e intelektualë të tjerë. Pastaj erdhën të gjithë. Kosova po i fal gjaqet, po shkundet nga një pjesë e zymtë e traditës një popull i vogël, por krenar. Në botën e qytetërimit nuk mund të hyhet me gjak. Duhet braktisur kjo paudhësi... Kështu nisi e mori udhë. Një dritë jete furishëm u hodh në ato udhë të verbra të dheut. Jeta po çel udhë... çelni udhë rinisë..., është

kjo porosia e madhe e një njeriu të madh: porosia e Anton Çettës.

- Ju kthyet edhe një herë terrenit, përkatësisht udhëve të dheut, në një mision shumë human e qytetërues, për çrrënjosjen e gjakmarrjes në këto troje...?

Anton Çetta: Po, terreni më bëri që ta njoh më mirë popullin tim, t'i shoh kërkesat, aspiratat, përpjekjet, vuajtjet, mungesat dhe të gjitha ato që e bëjnë jetën

e tij të përditshme. E kuptova shpejt se popull im ka kërkesa shumë modeste, e sidomos dëshiron të ndiejë fjalën e mirë, fjalën ngushëlluese e këshilluese, të ndiejë se ka kontakte të drejtpërdrejta me njerëzit e qytetit, që dikur i dukeshin si të largët, të ndiejë se ky njeri i qytetit intelektual i është afruar, është pranë tij dhe flet me të me zemër të hapur, tash si mik i vërtetë, e u mor vesh, nga këto njohuri të reja që i fitova e pashë se duhet punuar

e përkushtuar, me dashuri dhe zell. Mu për këtë tashti u paraqit kërkesa e të rinjve, e studentëve që të pajtohen gjaqet ndër ne përgjithësisht. Rinia më ftoi e unë me gjithë zemër pranova që të nisem me ta, që nga fillimi i shkurtit të këtij viti.

- Si filloi, si erdhi deri te dukuria e gjakmarrjes ndër ne?

Anton Çetta: Një pjesë e gjakmarrjeve bëhet nga interesat pronësorë, pra së bashku me interesat pronësorë-

ekonomikë, nisin edhe vrasjet e, me këtë, edhe gjakmarrja. Thelbi, si e kuptoj unë, apo arsyeja parësore e gjakmarrjes do të duhej të jetë: si t'i ndalet dora të fortit, i forti ka mundur të bëjë çdo gjë, i forti ka pasur njerëz në dispozicion, harambashë, argatë..., ka pasur mundësi të zgjerojë pronën, por me anë të gjakmarrjes njerëzit janë detyruar të ndalojnë zullumin, ngase dhe ai tjetri i cili bën dëm, do të mund të dëmtohej.

Kanuni i Lekë Dukagjinit e paraqet thelbin e gjakmarrjes midis të pafuqishmit dhe të fuqishmit "Gjaku për gjak", "Nga i miri len i keqi, nga i keqi len i miri". Kështu edhe i forti ka qenë i detyruar të mendojë mirë para se të vrasë, se edhe atë e ka pritur gjakmarrja. Kështu gjakmarrja e ka penguar keqpërdorimin e fuqisë.

- Gjakmarrja e kodifikuar në një praktikë kanunore ka vënë ligjësi edhe në këtë dukuri tragjike dhe absurde?

Anton Çetta: Ka qenë kjo një shoqëri pa ligje dhe pa shtet, familje patriarkale, kështu që në fillim gjakmarrja nuk ka qenë krejtësisht negative, në anën tjetër ai që ka humbur mashkullin e shtëpisë ka humbur edhe një fuqi punëtore. E varfëria ka qenë e madhe, kështu që gjaku ka mundur të falet për burrëri ose të merret, e në disa raste edhe të paguhet. Kjo në atë kohë mund të shpjegohej për arsye se i dëmtuari, meqë ka humbur një fuqi punëtore, ka marrë një kompensim sado të vogël. Ndërkaq, familjet fisnike e të pasura faljen e gjakut e kanë bërë për burrëri. Mirëpo, me zhvillimin e shoqërisë dhe vënien e themeleve të shtetit juridik, tashti i dëmtuari mbrohej me ligj, vrasja dënohej me ligj, por megjithatë tradita vazhdoi. Tashti ai që vriste, në një mënyrë kishte dy dënime: nga gjyqi dhe nga familja e të dëmtuarit. Ky dënim bëhej edhe më i madh me rastin e ngujimit, se gjaku nuk merrej aty për aty e familja e tërë duhej të ngujohej,

kështu që familja e vrasësit ndiente pasojat shumë të mëdha. Toka mbetej e papunuar, familja varfërohej. Me këtë rast edhe arsimimi i fëmijëve, por edhe emancipimi i femrës ishte i pamundur.

- Cilat janë pasojat psikologjike të familjeve që janë në gjak?

Anton Çetta: I zoti i shtëpisë dhe meshkujt e shtëpisë duke qenë të ngjuar, kaploheshin nga kompleksi i frikës, i dyshimit, i ankthit. Ata nuk mund të komunikonin lirisht me njerëzit e tjerë. Kompleksi i ngujimit rritej, ndiheshin të kufizuar në ngritjen e tyre. Pësonin edhe fizikisht, nga pamundësia që të lëvizin lirisht. Edhe në jetën e përditshme në këtë familje, as festat, as dasmat e as tubimet gazmore nuk bëheshin, por këta as nuk shkonin te të tjerët. Edhe ato momente të pakta të gëzuara këto familje nuk mund t'i shijonin. Pastaj as mendimet nuk i kishin të kthjellëta, duke jetuar vazhdimisht nën presionin e frikës e të ngujimit. Në anën tjetër, familja që ishte e dëmtuar po ashtu nuk ishte e qetë, ngase, sipas traditës, duhej ta merrnin gjakun, duhej të vrisnin për ta nxjerrë gjakun. Por gjaku nuk mund të merrej menjëherë, ngase ai që kishte vrasërin e mbyllur, kështu që marrja e gjakut shtyhej për një kohë të gjatë. Ai, i cili kishte për të marrë gjak ishte gjithmonë i shqetësuar, duke u përgatitur ta bënte këtë. Gjakmarrja u bë si kult, instinkt dhe domosdoshmëri. Në anën tjetër, edhe kur ishte në kontakt me njerëzit e tjerë, në ndeja nëpër

oda, atë që s'e merrte gjakun e shikonin si njeri të kategorisë më të ulët, sepse s'e kishte marrë gjakun ende. Kështu që edhe vendi i caktohej diku në fund të odës! Me një fjalë, ai nënçmohej.

- Përpara kanë ekzistuar këshillat e pajtimit apo islihatet. Edhe tash po e quajmë Këshilli i Pajtimit, por cili është dallimi midis këtyre këshillave?

Anton Çetta: Islihatet kanë qenë misione nga grupe të ndryshme e të herëpashershme njerëzish, por që veprojnë me afate të gjata kohore, të formuara nga pleq me autoritet, që çmoheshin nga njerëzit dhe që gëzonin besimin e tyre, por ishin të rralla. Ato kishin fuqi ekzekutive, ato "prenin me shpatë"! Vendimi i tyre duhej të zbatohet. Islihatet ka pasur gjatë kohës së Lidhjes së Prizrenit, ngase Lidhja e Prizrenit i mori në besë të gjitha gjaqet. Me këtë besë nuk duhej të vriteshin njerëzit në konflikt gjatë Lidhjes së Prizrenit. E kush vriste e "prente" në besë Lidhjen e Prizrenit! Lidhja e Prizrenit e dënonte, ngase kishte autorizime, fuqi ekzekutive e, njëkohësisht, islihatet morën përsipër të pajtoheshin ato gjaqe. Edhe më vonë, gjatë Besëlidhjes së Pejës, më 1911, kemi pasur islihatet, me në krye Haxhi Zekën. Pastaj një islihat i tillë ka vepruar në vitin 1923. Prijës i këtij islihati ishte Shaqë Avdia, i cili edhe vetë kishte falur gjakun e dy djemve të tij. Islihati i detyronte njerëzit të pajtoheshin. Disa pleqëri, që nuk mund të

zgjidheshin nga pleqtë apo mexhli si burrave, liheshin për më vonë, që të zgjidheshin në një formë më kategorike. Mirëpo kohët ndryshuan. Islihatet e dikurshme mund t'i krahasojmë deri diku me këto grupet e sotme, që quhen "këshilla pajtimi", por unë do t'i quaja grupe të rinisë për pajtim. Por këto, megjithatë, kanë ndryshim të madh nga islihatet. Së pari, këto janë grupet e të rinjve. Rinia e ka marrë këtë iniciativë e më pas iu janë bashkuar disa pleq e intelektualë. Por barra i bie rinisë. Në anën tjetër, parimet që ndjekin të rinjtë për pajtimin e gjaqeve janë krejt të kundërta ose shumë të ndryshme. Gjaku duhet të falet për burrëri dhe nuk paguhet. Siç ka qenë në praktikën e mëhershme, sipas Kanunit të Lekës, gjaku edhe kur falej për burrëri, paguhej me ndonjë shumë simbolike, ndërkaq sot nuk paguhet asnjë metelik! Nuk ka kurrfarë shpërblimi për familjen e dëmtuar, ngase shpërblimi më i madh është vetë akti i faljes së gjakut. Shpërblimi i degradon të vdekurin dhe vetë familjen që e fal gjakun. Me shpërblim e komercializojmë gjakun. Gjaku shndërrohet në monedhë, por këtë nuk e lejon rinia, nuk e lejon tradita e shndritshme shqiptare. Shpërblimi ia zbeh fytyrën të vdekurit. Zbehet familja e atij që fal gjakun. Më ka rastisur para 15 vjetësh të ndodhem në një odë, ku u fol për faljen e një gjaku. Duke biseduar, një plak tha: "E kishte falur filani gjakun". Tjetri ia priti: "Po more, e kishte falur me pare

dhe kishte filluar të ndërtojë një shtëpi!". Kështu, gjaku i paguar me para do të bënte shtëpi! Me këtë rast tashti së voni, Azem Shkreli na la një fjalë vërtet burrërore: "Për burrëri burrat falin burrërisht". Kjo na mbeti si moto e këtij misioni. Një element tjetër që praktikohet përpara e që ne nuk e përdorim sot, ishte dorëzania: ata quheshin dorëzanët e gjakut. Ishin njerëz që dëshironin të bënin mirë, mirëpo dorëzanët (garantët) shpesh priteshin në besë! Kështu, ndonjë pjesëtar i familjes që falte gjakun, qëllonte ta merrte gjakun përsëri. Ç'ndodhte? Dorëzanët priteshin në besë. Ata atëherë kërkonin fytyrën, e për të nxjerrë fytyrën duhej të vritnin vetë. Ata e "nxirrnin" fytyrën, por binin në gjak. Kështu krijohej edhe një hallkë më tepër në zinxhirin e gjakmarrjes. Këtë metodë me dorëzani nuk e pranuan edhe për një arsye tjetër: sot i tërë populli është dorëzanë. Të rinjtë që marrin pjesë në pajtimin e gjaqeve janë dorëzanë. Nesër, kur t'i japim fund gjakmarrjes, ne do t'i botojmë të gjitha rastet e faljes së gjaqeve, kështu që do të mbetet edhe një dokument me shkrim, që do të jetë dorëzania më e madhe, që do të qëndrojë vite të tëra, ndoshta edhe me shekuj nëpër biblioteka.

- Profesor, sot ndodh që, në mungesë të meshkujve të shtëpisë, gjakun po e falin edhe femrat. Kjo do të thotë gruaja dhe nëna, motra apo mbesa...?

Anton Çetta: Gjakmarrja bëhet për shumë arsye, njëra ndër to



është ajo e shtimit, sugjerimet e vazhdueshme, rikujtimet e në këto merr pjesë shumëkush, për ta bindur gjakmarrësin të qesë pushkë, duke ia përkujtuar vazhdimisht: ç'bërë, a e more atë gjak etj. Ka ndodhur që edhe gruaja ka luajtur një rol negativ, me pretextin: nuk po më lënë rehat shoqet e mia, duke më thënë ç'bëri burri yt, a e mori gjakun? Pra, biseda të tilla e nxitin gjakmarrjen... Ndërkaq, në këto ditë roli i femrës është shumë pozitiv. Ne kemi pasur një rast, kur dy vëllezër kishin për të falur një gjak, por vëllai i vogël nuk donte ta falte. I thamë të shkante të këshillohej me anëtarët e familjes. Rastisi që në atë familje të ndodhej teza si mysafire; grua plakë, por burneshë. Ajo e bindi vëllanë e vogël për dhjetë minuta dhe na e solli për krahu: "Nuk duhet të ndodhë kurrë gjakmarrja! - tha ajo. - Çohuni n'këmbë dhe merruni n'grykë!"

Ka ndodhur që familja ka mbetur pa mashkull, siç ishte rasti i Sankocit të Drenicës, ku ajo familje kishte mbetur me pesë motra, dy të vogla fare. Ndërkaq e madhja, Hyra, ishte zotë shtëpie, madje i kishte kaluar edhe koha e martesës, nga dëshira për të marrë gjakun e babës! Ajo kishte sakrifikuar rininë, por fjala e mirë e rinisë, e studentëve, ia kishte zbutur zemrën dhe një ditë u ngrit midis burrash dhe e fali gjakun! Po kështu, të dielën e kaluar, një nënë fisnike në Prizren, që i thoshin nënë Zoja, fali gjakun e të birit...

Falja e gjakut është hap në demokraci!

- Është e qartë, çrrënjosja e gjakmarrjes është hap drejt proceseve demokratike, ngase, të shprehemi kështu, nuk bën që "në shtëpi të jesh i ngjuar apo në gjak e në çarshi të flasësh për demokracinë". Ç'mendonin ju?

Anton Çetta: U mor vesh. Akti i faljes së gjakut është një akt tolerance, njëkohësisht akt human, që i ofron njerëzit dhe familjet e armiqësuar. Pra, me kohë, duke e respektuar familjen që fal gjak, vijmë tek ato marrëdhënie vërtet miqësore. Ja, toleranca është shprehje e demokracisë, kërkesë thelbësore e demokracisë.

Pastaj akti i faljes së gjakut bëhet me bindje e jo si përpara, me para apo me ndërmjetësimin e pleqve që kanë pasur fuqi. Sot ata që falin gjakun binden për diçka që vërtet është humanizëm dhe qytetërim. Po ashtu, me këtë akt gjejmë edhe dialogun. Të rinjtë i bindin përmes dialogut, i cili sjell marrëveshjen. Duke qenë të lirë, familjet e ngjuara, sidomos meshkujt, bëhen fuqi prodhuese shumë aktive. Ja, pra, edhe në pikëpamje ekonomike është një hap në

demokraci! Tashti, pasi u falët gjaku, jeta e familjeve të ngjuara nis të zhvillohet normalisht edhe në pikëpamje kulturore. Fëmijët e ngjuar, që nuk kishin mundësi të shkollohen, tashti dalin lirisht. Ky është dimensionin arsimor i faljes së gjakut. Më kujtohet një rast i dhembshëm, kur në fakultet kishte një student shumë të mirë, andej nga katundet e Llapit. Vitin e parë të studimeve ai mori notë të shkëlqyeshme, me shkrim dhe me gojë. Ishte shumë simpatik, i zellshëm... Por, ai nuk erdhi të japë provimin e vitit të dytë, po ashtu as në vitin e tretë! Ç'ndodhi? Erdhi vitin e katërt, pas dy vjetësh "pushim". Kur e pashë, i thashë: "Po pse s'erdhe në provim, more djalë?". Profesor, - tha, - nuk kam mundur, se jemi në gjak! Jemi të ngjuar! Ata nuk na kanë dhënë besë, por sot kam ardhur tinëz!" Ky është një ndër kujtimet më të zymta në jetë dhe sot dhe sa herë që dalim në terren me të rinjtë për pajtim gjaqesh, më kujtohet ai djalë. Edhe ky rast më jep zemër për ta çuar deri në fund këtë mision.

- Cili ka qenë roli i besës në lehtësimin e gjakmarrjes?

Anton Çetta: Familjet burrërore kanë dhënë besë, herë pas here, sidomos gjatë kohës së punëve në fushë, për të mos mbetur arat djerrë krejtësisht, por ka pasur edhe raste kur nuk është dhënë besë. Atëherë meshkujt e shtëpisë kanë dalë të punojnë, por kanë qenë nën presion të vazhdueshëm të frikës. Besa në kompleksin e gjakmarrjes ka rolin e lehtësimin ndaj familjes së ngjuar, që të ketë liri për një kohë të caktuar.

Si shkelen të drejtat e njeriut?

-Ka raste që falja e gjakut shihet me sy tjetër, madje shihet edhe me „sytë“ e policisë. Ç'do të thotë kjo?

Anton Çetta: Ndodhi një rast, ku në Bellacërk të Rahovecit u falën shtatë gjaqe. Të nesërmen morëm vesh se në një familje të fshatit Gexhe kishin shkuar organet e sigurimit dhe i kishin rrahur tetë anëtarët e familjes, e disa prej tyre ishin dënuar me nga 30 ditë burgim. Po ashtu, në fshatin Dushanovë, njerëzit janë torturuar pas faljes së gjakut. Padyshim që këto janë sjellje arrogante dhe shkelje e të drejtave elementare njerëzore, kur dihet se falja e gjakut është gjest shumë human, një aksion fisnik për zhdukjen e një plage të zymtë në Kosovë, por edhe në Jugosllavi, prandaj konsiderojmë se falja e gjaqeve është hap qytetëruar për shtetin tonë, e të pengohet ky aksion nga ndonjë element është anakronizëm. E dini: gjakmarrjen e dënon edhe ligji penal, madje rëndë, ngase bëhet me paramendim, kështu që të falësh gjakun, do të thotë t'i shërbesh shoqërisë, shtetit juridik po e po...

- Ndodh që pushteti në ndonjë periudhë të caktuar, në mënyrë indirekte, e ka nxitur procesin e gjakmarrjes, duke lënë të hapura shumë burime konfliktuese midis njerëzve?

Anton Çetta: Regjimeve jopopullore për të qeverisur më lehtë u ka leverdisur të ketë konflikte të vazhdueshme, kështu që kanë përdorur nxitjen apo përçarjen për të ndërhyrë

me disa elemente të deformuara në vrasje. Pra, kanë ndodhur vrasje me motive politike, nga intrigat dhe cytjet e njerëzve të deformuar. Pikërisht në këto raste po hasim më shumë pengesa për t'i pajtuar, ngase i dëmtuari thotë nuk na ka vrarë hasmi, por tjetërkush dhe nuk di kujt duhet t'ia falë gjakun!

- Gjakmarrja ka ekzistuar edhe te popuj të tjerë, mirëpo është tejkaluar. Cilët janë faktorët që ndikojnë në zhdukjen e saj?

Anton Çetta: Gjakmarrjen e kanë pasur pjesë të traditës malazezët, korsikanët, por edhe francezët etj. Mirëpo me ngritjen ekonomike e kulturore, si dhe të vetëdijes kombëtare, kjo është tejkaluar. Të përmendim për ilustrim romanin „Kolomba“, që përfshin parimet kryesore: një motër ka vetëdije patriarkale, ndërkaq vëllai shkon në Paris, ku shkollohet. Më pas kthehet për pak në Korsikë, pa i shkuar mendja të marrë gjakun, ngase ai ishte i emancipuar, kishte bërë karrierë... Por e motra ngadalë-ngadalë nis t'ia shprushë kujtimet për babanë... E çon të vizitojë varrin e tij, pastaj e cyt vazhdimisht, saqë e bind edhe intelektualin që të marrë gjakun. Kjo tregon se sa i fuqishëm është presioni i aktit të gjakmarrjes.

- Mbase shpërblimi më i madh është vetë akti i faljes së gjakut. Si e ndieni veten kur shtrihet dora e pajtimit?

Anton Çetta: Shpërblimi më i lartë për mua dhe të gjithë të rinjtë dhe intelektualët e tjerë që marrin pjesë në pajtim është kënaqësia që ndiejmë kur e shohim se patëm sukses dhe kur i shohim duke u përqafuar ata që, vetëm disa çaste më parë, janë konsideruar hasëm midis tyre. A ka shpërblim më të madh sesa kur rrjedhin lotët e gëzimit! E çdo gjak i falur është një kontribut i madh për faljen e të gjitha gjaqeve. Kjo bën që të mos ndihet as lodhja, as pleqëria.

- Pastaj në Shtimje, më vonë edhe gjetkë, u propozua që në shenjë nderimi, Këshilli i

Pajtimit dhe ky aksion të pagëzohet "Anton Çetta". A s'është edhe ky një shpërblim?

Anton Çetta: Nuk jam pajtuar të quhet kështu ky aksion, ngaqë ai është një aksion i rinisë studentore, se ata e kanë filluar dhe ata do ta çojnë deri në fund. Unë do të gëzohesha, pra, sikur ky aksion të quhet *Aksioni i Rinisë Studentore për Pajtimin e Gjaqeve*. Të rinjtë na ftuan e ne shkuam pa u hamendur, sikur të shkonim në fejesën apo në dasmën e tyre.

- Profesor, gjatë këtij aksioni hasëm në toponime, si Lëndina e Varreve, Kodra e Varreve e ato tashti po ripagëzohen, si Lëndina e Pajtimit, Kodra e Pajtimit, Lëndina e Krushqve etj. Ç'do të shtonin për këtë ripagëzim?

Anton Çetta: Ne nuk dimë kur ka ndodhur ngjarja, që lidhet me Varret e Krushqve, por e dimë datën e Kodrës së Pajtimit... Janë këto toponime origjinale nga populli dhe kuptimplot!

- A mund të veçoni ndonjë çast, kur jeni prekur thellë gjatë këtij aksioni?

Anton Çetta: Rasti i Llaushës së Drenicës, kur Nezir Vojvoda fali gjakun e të birit e ky ishte djali i tij i tretë që kishte humbur jetën tragjikisht (i dyti, Selmani, u vra sivjet nga Aradha e Bashkuar e Milicisë në Mitrovicë). Ai na priti, na fali gjakun dhe na përcolli si burrat, por kur dolëm, mendova: "Ky burrë tashti do të mbetet vetëm...". Atëherë më shpërtheu vaji, por ja edhe kjo është jeta, fati ynë.

- Profesor, në fund e lyp burrëria dhe e do rendi të na lësh ndonjë porosi apo urti.

Anton Çetta: Të bëni çmos, që deri në Vitin e Ri të mos ketë më asnjë gjak të pafalur në Kosovë. Të ndikojmë me fjalën tonë të urtë, të shtrihet dora e pajtimit. Pse të bartim këtë barrë të rëndë e të neveritshme, kur na fisnikërojnë virtyte të tjera të larta nga tradita, si BESA, BUJARIA, MIKPRTIJA, GAJRETI, PRA, PLAGËN E GJAKMARRJES. TA ZHDUKIM!

Përgatiti: Mal Qorraj



Gjendja me Covid në Malishevë është në kontroll

MALISHEVË, 2 NËNTOR (ER) - Gjendja me Covid-19 në Komunën e Malishevës është në kontroll dhe momentalisht janë 18 raste aktive. Pavarësisht kësaj gjendjeje, kjo komunë ka filluar që, krahas masave të mëhershme, ta zbatojë edhe vendimin e fundit të qeverisë për masat shtesë mbrojtëse. Kjo është bërë me dije në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha. Nënkryetari Berisha ka kërkuar nga të gjitha drejtoritë që të punojnë me staf të reduktuar, përkatësisht personat e vjetër dhe personat me sëmundje

kronike të lirohen përkohësisht, si dhe ka kërkuar që të shkurtrohet puna me palë, përjashtuar rastet e domosdoshme, por puna të vazhdojë normalisht. Ndërsa drejtori për Shëndetësi, Liridon Hoti, ka bërë me dije se në QKMF-në e Malishevës është rritur numri i pacientëve si dhe ka parashtruar nevojën e rritjes së numrit të punëtorëve shëndetësorë, edhe pse janë duke u kryer të gjitha shërbimet.

Edhe në fushën e arsimit drejtori komunal për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, ka bërë me dije se procesi mësimor është duke vazhduar normalisht dhe në

rastet kur mësimdhënësit duhet të izolojnë për shkak të kontakteve me rastet aktive me Covid, ata zëvendësohen. Ndërsa drejtori i Inspektoratit, Dibran Kastrati, ka treguar se kanë marrë vendimin e qeverisë për masat shtesë dhe inspektorati do të jetë në vazhdimësi në terren për zbatimin e këtyre masave. Ai ka theksuar se deri më tani janë proceduar më shumë se pesëqind lëndë për gjykatë për rastet e moszbatimit të masave nga ana e subjekteve afariste apo qytetarëve.

Në anën tjetër, drejtoresha e Administratës, Besartë Kryeziu-Ramaj, ka thënë se janë duke u kryer të gjitha shërbimet në komunë, ndërsa drejtori i



Shërbimeve Publike, Milazim Morina, ka njoftuar se janë duke u kryer të gjitha shërbimet komunale, si furnizimi me ujë dhe grumbullimi i mbeturinave.

Fillon ndërtimi i disa rrugëve në Rogovë të Hasit



GJAKOVË, 2 NËNTOR (ER) - Komuna e Gjakovës ka njoftuar se kanë filluar punimet për ndërtimin dhe asfaltimin e dhjetë akseve rrugore në fshatin Rogovë të Hasit. Me këtë rast, kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, ka theksuar se këto rrugë kapin vlerën e rreth 111 mijë eurove. "Këtë vit në fshatin më të

madh të Komunës së Gjakovës i nisim dhjetë akse rrugore me gjatësi 2 300 metra, projekt ky që kap vlerën financiare rreth 111 mijë euro. Me këto rrugë dhe dy të tjera të cilat janë të planifikuara nga Qeveria e Kosovës, përfundojmë infrastrukturën rrugore publike në Rogovë të Hasit.

Vitet në vazhdim do të punojmë në kanalizime dhe ndriçim publik", ka thënë Gjini.

Kryetari Gjini dhe nënkryetari Flamur Fetahaj janë pritur nga banorët e kësaj ane, të cilët janë shprehur të lumtur për jetësimin e këtij projekti të rëndësishëm për mirëqenien e tyre.

Mbahet ekspozita "Kolonja e Artistëve" në nderim të heroit Zahir Pajaziti

Podujevë, 2 nëntor (ER) - Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, i shoqëruar nga drejtoresha e Drejtorisë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Donika Sfishta, kanë vizituar ekspozitën "Kolonja e Artistëve". "Kolonja e Artistëve", e cila është organizuar për herë të parë, është mbajtur në fshatin Orllan të Podujevës, ku për dy ditë me radhë, artistë nga

trojet shqiptare kanë krijuar vepra të ndryshme artistike, të cilat i kanë ekspozuar në Kompleksin Memorial "Zahir Pajaziti" në Orllan. Ekspozita është organizuar në nderim të heroit tonë kombëtar, Zahir Pajaziti, me rastin e ditëlindjes së tij. Nënkryetari Rudari ka premtuar mbështetje nga Komuna e Podujevës që ky organizim të bëhet tradicional.



Mitrovicë, miratohet vendimi për rialokimin e mjeteve financiare nga fondi rezervë




Mitrovicë, 2 nëntor (ER) - Me kërkesë të kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, drejtuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Safet Kamberi, si dhe në prani të nënkryetarit Faruk Mujka, asamblistëve dhe drejtorëve të administratës komunale është mbajtur mbledhja urgjente e Kuvendit të Komunës.

Në këtë mbledhje pikë e vetme e rendit të ditës ishte rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02-060/01-0067314/20-1 të datës 26.10.2020 për rialokimin/transferimin e mjeteve financiare nga fondi

rezervë.

Me këtë rast, drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka njoftuar asamblistët lidhur me rishqyrtimin e vendimit në fjalë duke u bazuar në Ligjin e financave të pushtetit lokal nr. 03/L-049, Neni 25, respektivisht të respektohet granti i arsimit si dhe Nenin 5 të Ligjit për buxhetin e rishikuar nr. 07/L-14. Pas disa diskutimesh, kjo pikë me shumicë votash është miratuar nga asamblistët komunalë, për t'u dërguar pastaj te Ministria e Financave për rishqyrtim dhe rialokim të mjeteve nga fondi rezervë.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

LLAPI NDRYSHON MENDJE, VAZHDON GARAT NË SUPERLIGË

Lajm i mirë për futbollin e Kosovës është vendimi i Llapit për mostërheqje nga garat e Superligës. Drejtuesit e këtij klubi janë të vendosur t'i vazhdojnë garat pavarësisht prej dëmtimeve nga gjyqtarët, kurse drejtuesit e FFK-së i kanë dhënë garanci Llapit se më nuk do të ketë tendenca dhe dëmtime ndaj tyre



Llapit. Drejtuesit e Llapit kanë mbajtur edhe takimin online, ku vendosën përfundimisht që të mos tërhiqen nga garat në elitën e futbollit të Kosovës. "Pas takimit me FFK-në u organizua mbledhja online me kryesinë e klubit, të cilët, edhe pse të tronditur nga referimi i djeshëm, menduan që duhet të jemi në gjendje gatishmërie ta zhvillojmë kampionatin deri në fund, pa marrë parasysh ngjarjet e ndodhura së fundmi në dëm të KF Llapit", thuhet në njoftimin e klubit llapjan. Skuadra e Llapit në këtë edicion ka zhvilluar nëntë ndeshje dhe ka grumbulluar vetëm pesë pikë, duke u renditur në pozitën e parafundit në renditjen tabelore. Llapi ndeshjen e mbetur do ta zhvillojë kundër Dritës nga Gjilani.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Skuadra e Llapit nuk do t'i braktisë garat dhe do të jetë pjesë e Superligës së Kosovës në futboll. Trajneri Tahir Batatina dhe drejtuesit e tjerë të këtij klubi, të irrituar pas humbjes se pësuar të dielën nga Drita (1-2), paralajmëruan se do të largohen nga garat për shkak se gjyqtarët në vazhdimësi po e

dëmtojnë qëllimisht klubin nga Podujeva. Megjithatë, ky paralajmërim i drejtuesve të klubit llapjan ka ndryshuar të hënën pas takimit që pati trajneri Tahir Batatina me drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës. Në njoftimin për media të Klubit të Futbollit Llapi, thuhet se ky klub ka marrë mbështetjen e kryetarit të FFK-së, Agim Ademi dhe të nënkryetarit Agim Dibrani, se

më nuk do të ketë tendenca dhe dëmtime ndaj tyre. "Pas takimit që patëm me kryetarin e FFK-së, Agim Ademi, si dhe nënkryetarin Agim Dibrani, është diskutuar për ndeshjen ndërmjet Llapit dhe Dritës, në të cilën skuadra jonë u dëmtua në mënyrë të tmerrshme nga gjyqtarët e ndeshjes. Në takimin e sotëm kryetrajneri i

KF Llapi, Tahir Batatina, shfaqti brengën e tij në lidhje me referimin nga fillimi i këtij edicioni, duke menduar seriozisht tërheqjen nga garat e Superligës për këtë edicion. Por krerët e FFK-së theksuan se KF Llapi e meriton të jetë pjesë e Superligës dhe më nuk do ketë tendenca dhe dëmtime ndaj klubit", thuhet në njoftimin e

ADEMI, GJYQTARËVE: DUHET TË JENI MË VIGJILENTË



Prishtinë, 2 nëntor - Pas fillimit të ndeshjeve të fazës së dytë në Superligën e Kosovës në futboll dhe analizimit të rasteve kontestuese në xhirot e fundit nga profesionistët të ndarjes së drejtësisë, kryetari Agim Ademi, nënkryetari Agim Dibrani, sekretari i përgjithshëm Eroll Salihu dhe kryetari i Komisionit të Gjyqtarëve, Përparim Hasani, kanë mbajtur takim me gjyqtarët e Superligës. FFK-ja ka njoftuar se kryetari Ademi ka kërkuar nga gjyqtarët

që të jenë sa më vigjilentë dhe ta kryejnë punën e tyre në përpikëri, derisa ua ka bërë të qartë se masat ndaj atyre që do të bëjnë gabime do të jenë të ashpra deri në delegim në ligat më të ulëta. "FFK-ja ka investuar vazhdimisht në gjyqtarë të rinj dhe do ta vazhdojë punën në këtë drejtim ngaqë, krahas rritjes së cilësisë së ligave, synon që të ketë rritje të kapaciteteve dhe profesionalizmit edhe te gjyqtarët dhe organet e tjera të

saj. Komisioni i Gjyqtarëve së shpejti do të organizojë sërish normat fizike për gjyqtarët, me qëllim që në ndeshje të delegohen gjyqtarët më të përgatitur. Po ashtu, FFK u bënë thirrje edhe drejtuesve të klubeve që të mos bëjnë deklarata të pamatura dhe presion te gjyqtarët, sepse gjërat e tilla nuk do të tolerohen. Ndërkohë, sot (e martë), do të mbahet takimi edhe me gjyqtarët e Ligës së Parë", thuhet në njoftimin e FFK-së.

KRYETARI I RAHOVECIT I OFRON MBËSHTETJE SPORTISTIT ERZEN ZYBERAJ

RAHOVEC, 2 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, të hënën e ka pritur në takim sportistin e njohur nga kjo komunë, Erzen Zyberaj. I pari i Rahovecit ka thënë se futbollisti dhe atleti Zyberaj po e bën krenar të gjithë Rahovecin, prandaj mbështetja e komunës nuk do të mungojë. "Mëngjesin e nisa me një takim të këndshëm me futbollistin dhe vrapuesin Erzen Zyberaj. Erzeni vjen nga Drenoci i Rahovecit

dhe po na bën krenar gjithandej. Përveçse një futbollist i dalluar, ai është edhe një atlet i shkëlqyer, i njohur për vrapimin ultramaratonik nga Prishtina në Rahovec, më saktësisht në vendin e tij të lindjes, në Drenoc, ku edhe ka përfunduar me sukses vrapimin prej 63 kilometrave për vetëm 5 orë e gjysmë, me ritëm mesatar të vrapimit 5.14 minuta për kilometër", ka shkruar kryetari Latifi në profilin e vet në "Facebook". "Së fundmi Erzeni

ka arritur ta rrëmbejë edhe vendin e parë në maratonën virtuale 'Prishtina 2020', andaj e përgëzoj për arritjet e njëpasnjëshme dhe i dëshiroj mbarësi dhe suksese në rrugëtimin e tij, po ashtu e siguroj se mbështetja komunale nuk do të mungojë. Kam bindjen se ky djalosh i përgatitur edhe më tej do të korrë suksese duke u radhitur te futbollistët dhe atletët më të mirë. Suksese dhe le të të prijë e mbara!", ka shtuar Latifi.



Gjimshiti: Duam fitoren ndaj Liverpoolit

BERGAMO, 2 NËNTOR - Mbrojtësi i Shqipërisë dhe i Atalantës, Berat Gjimeshi, kërkon që skuadra e tij të sigurojë rezultat pozitiv ndaj Liverpoolit, edhe pse kampionët e Anglisë janë favoritë për të

fituar në Bergamo. Pas mbërritjes deri në çerekfinale edicionin e shkuar, skuadra e shqiptarit do të tentojë edhe këtë vit ta bëjë surprizën. "Gjëja më e rëndësishme për ne është

të fitojmë. Tani përballlemi me Liverpoolin me më shumë besim. Kemi disa probleme fizike dhe na duhen disa ditë për ta marrë veten. Rëndësi ka që luajmë në shtëpi dhe të marrim

një rezultat të mirë", ka thënë qendërmbrojtësi Berat Gjimeshi. Ndeshja në mes të Atalantës dhe Liverpoolit zhvillohet sonte (e martë) nga ora 21:00.



Reali dhe Interi në kërkim të fitores së parë



MADRID, 2 NËNTOR (ER) - Real Madridi nuk e ka nisur në mënyrë të mirë edicionin e ri në Ligën e Kampionëve, pasi në dy ndeshje ka grumbulluar vetëm një pikë. "Mbretërit" sonte (e martë) janë në kërkim të fitores së parë në garën më të fortë në futboll, kurse mysafir i tyre është Interi. Përveç dy dështimeve në këtë edicion, Reali pësoi edhe dy humbje nga Manchester City në edicionin e kaluar dhe është në katër ndeshje pa fitore. Pavarësisht prej faktit se Reali është në pozitën e fundit në grup, synim i tij është që fillimisht ta fitojë ndeshjen e sotme dhe më pas ta sigurojë edhe kualifikimin për fazën e ardhshme. Reali në ndeshjen e fundit në La Liga fitoi me rezultat bindës ndaj Huesca (4-1). Në anën tjetër, Interi, i cili në edicionin e kaluar shkoi deri në finale të Ligës së Evropës, ka shpresuar në një fillim më të mirë në këtë edicion në Ligën e Kampionëve,

por ndaj Moenchengladbachut luajti (2-2) dhe ndaj Shakhtarit (0-0). Interi edhe në fundjavë luajti baras me Parmën (2-2). Mungesat e Realit për këtë ndeshje janë Nacho, Martin Odegaard, Dani Carvajal dhe Alvaro Odriozola. Ndërsa Romelu Lukaku është në dyshim për Interin. Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, në konferencën për shtyp një ditë para ndeshjes së Ligës së Kampionëve kundër Interit, ka thënë se skuadrën e tij e pret nesër një ndeshje delikate. "E njoh shumë mirë Interin. Do të jetë sfidë delikate, një 'luftë' në të dy krahët. Ata janë shumë të fortë fizikisht dhe do të na e bëjnë të vështirë", u shpreh fillimisht Zidane. Në ndeshjen tjetër të Grupit B do të përballen Shakhtari dhe Moenchengladbachu. Një tjetër ndeshje interesante sonte zhvillohet edhe në Bergamo, ku skuadra e Berat Gjimeshitit, Atalanta, e pret skuadrën e Xherdan Shaqirit, Liverpoolin.

Mandzuziqi preferon Italinë para Anglisë

Mario Mandzuziq është ende pa skuadër. Sulmuesi kroat ka disa oferta, por ende duket i pavendosur për destinacionin e ri teksa mësohet se e fundit që ka refuzuar është nga Premierë Liga. Aston Villa ishte gati ta afronte 34-vjeçarin me një ofertë e cila është kthyer mbrapsht dhe mesa duket sulmuesi dëshiron të luajë sërish në Serinë A. Janë disa klube italiane që e duan lojtarin dhe së shpejti mund të ketë të reja mbi të ardhmen e tij por, gjithashtu, nuk përjashtohet as kalimi i kroatit në Major League Soccer.

Totti infektohet me Covid-19

Legjenda e Romës, Francesco Totti, ka rezultuar pozitiv në analizat e koronavirusit. Sipas "Sky Sport Italia", Totti ka bërë testin, meqenëse ka pasur disa simptoma në ditët e fundit. Italiani ka filluar të bëhet më i dobët dhe rezultatet e testeve kanë dalë pozitive. Thuhet se Totti ka nisur të përmirësohet, ndërsa mbetet të shihet se kur do të shërohet. Ndërkohë, kujtojmë se në tetor Totti humbi babanë shkak i koronavirusit, por prindi i tij kishte probleme edhe me diabet.

GRUPI A

18:55 Lokomotiv M. - Atletico Madrid
21:00 Salzburg - Bayern M.

Tabela

1. Bayern M.	2	6 pikë
2. Atletico M.	2	3
3. Salzburg	2	1
4. Lokomotiv M.	2	1

GRUPI B

18:55 Shakhtar D. - B.Moenchengladbach
21:00 Real Madrid - Inter

Tabela

1. Shakhtar	2	4 pikë
2. Moenchengladbach	2	2
3. Inter	2	2
4. Real Madrid	2	1

GRUPI C

21:00 Porto - Marseille
21:00 Manchester City - Olympiacos

Tabela

1. Man City	2	6 pikë
2. Porto	2	3
3. Olympiacos	2	3
4. Marseille	2	0

GRUPI D

21:00 Atalanta - Liverpool
21:00 Midtjylland - Ajax

TABELA

1. Liverpool	2	6 pikë
2. Atalanta	2	4
3. Ajax	2	1
4. Midtjylland	2	0

Klopp: Na ka munguar shumë Shaqiri

LIVERPOOLI, 2 NËNTOR - Xherdan Shaqiri bëri një paraqitje të mirë për Liverpoolin në fitoren kundër West Ham United (2-1). Trajneri i kampi-

onëve të Anglisë, Jürgen Klopp ka thënë se skuadrës së tij i ka munguar shumë futbollisti shqiptar. "Ai di të luajë në shumë pozicione. Ishte i

dëmtuar, nuk u përjashtua për arsye disiplinore. Na mungoi shumë, ai është një lojtar shumë i mirë, pati ndikim të madh. Jam i lumtur që e kam

përsëri në skuadër. Kur merkato të hapet thashethemet për largimin e tij do të fillojnë sërish", ka deklaruar Klopp.



SHKURT

Bunjaku, MVP i xhiros së dytë

Golden Eagle Ylli ka fituar përballjen me Bashkimin me rezultat 91:77 në kuadër të javës së dytë të Superligës së Kosovës në basketboll. Një nga lojtarët më të merituar të therandasve në këtë fitore ishte Valon Bunjaku. Basketbollisti i Përfaqësueses së Kosovës ndaj Bashkimit shënoi 22 pikë, kishte pesë kërcime, 13 asistime dhe tre topa të vjedhur, me një efektshmëri 31, duke qenë basketbollisti më i mirë i kësaj ndeshje, por edhe xhiros së dytë në basketboll. Ish-basketbollisti i Sigal Prishtinës disa herë edhe në edicionin e kaluar ishte zgjedhur lojtari më i mirë i javës dhe topshënuesit e javës. Valoni është edhe anëtar i rregullt në Përfaqësuesen e Kosovës, që në muajin nëntor do të përballlet me Sllovakinë dhe Islandën në ndeshjet që do të zhvillohen në Bratislavë.

Mourinho: Këto skuadra janë në garë për titull në Premierë Ligë

Trajneri i Tottenhamit, Jose Mourinho, ka folur rreth skuadrave të cilat ai i sheh si pretendente për ta fituar titullin e kampionit në Premierë Ligë këtë edicion. Trajneri portugez nuk e ka përjashtuar fare skuadrën e tij nga kjo luftë, duke e parë atë si një ekip të kompletuar dhe të gatshëm për të luftuar deri në fund për titullin e më të mirë në Angli. "Këtë sezon kemi ekip të kompletuar. Jam i sigurt që deri në fund do të luftojmë për titullin kampion. Në këtë garë shoh një luftë të ashpër edhe me ekipet si Liverpooli, Manchester City dhe Chelsea", ka thënë Mourinho.

McGregor: Khabibi është më i miri në këtë sport

Boksieri Conor McGregor është pyetur lidhur me rivalin Khabib Nurmagomedov, për të cilin u shpreh se është më i miri. Në duelin e zhvilluar mes Khabibit dhe Conorit fitues doli rusi, derisa McGregor që nga ajo ditë ka kërkuar rimeçin, transmeton lajmi.net. Mirëpo, ky rimeç mund të mos zhvillohet asnjëherë meqenëse Khabib është pensionuar nga UFC. I pyetur nga fansat për mendimin që ka për Khabibin, McGregor e quajti luftues fenomenal dhe momentalisht më i miri në këtë sport. "Luftues fenomenal. Momentalisht më i miri në këtë sport. Unë u përgjigja, sidoqoftë ata e dinë", ka thënë ai. Khabib, pas fitores ndaj Justin Gaethje, që e la pa ndjenja në raundin e dytë, njoftoi largimin nga UFC duke u pensionuar i pamposhtur me rekordin 29-0.



Izet Sarajliqi (1930-2002) është një ndër poetët boshnjak më të njohur. Sarajliqi është konsideruar një prej autorëve kryesorë të Evropës Lindore dhe është kandiduar për çmimin Nobel për letërsi. Sarajliqi ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Bosnje dhe Hercegovinës. Është vlerësuar me shumë çmime, edhe me çmimin prestigjioz "Alberto Moravia" (2001). Gjatë luftës (1992-1995) refuzoi të largohej nga Bosnja. Në këtë luftë, në të cilën u plagos, humbi dy motrat, Ninën dhe Razën, të cilat përmendën në këtë libër. Poezitë e Sarajliqit janë përkthyer dhe botuar në: italisht, frëngjisht, holandisht, gjermanisht, slovenisht, rusisht, lituanisht, anglisht, turqisht, maqedonisht, spanjisht, në gjuhën polake e në disa gjuhë të tjera të botës, edhe në shqip.



Në parathënien e këtij libri është ky paragraf: *Në Sarajevë, të cilën e deshi shumë dhe me poezi shkruar për të e bëri të njohur në mbarë botën, pothuajse askush nuk e kujton më. Madje asnjë rrugë të këtij qyteti nuk ia dhanë emrin e tij.* Kështu shkruan dhe shpreh shqetësim e bija e poetit, Tamara Sarajliq Slavniq, e cila, në korrespondencat me postë elektronike, na njofton se babai i saj, Izeti, sa ishte gjallë kishte qenë disa herë në Prishtinë, se i donte shumë shqiptarët, se u fliste fëmijëve të vet shumë për qytetet e Kosovës, për takimet që kishte pasur disa herë me poetë shqiptarë në mbremjet poetike që atëkohë organizoheshin në Kosovë dhe në Maqedoni. Po ashtu, shpreh kënaqësi që, pas librit të parë, *Kërkoj rrugë për emrin tim*, përkthyer në gjuhën shqipe, në fund të viteve '70, nga Azem Shkrelu, Enver Gjergjeku, Qerim Ujkanë, Ali Podrimja dhe botuar nga *Rilindja* më 1978, po në shqipe po i përkthehet dhe botohet libri i dytë, *Përmbledhja sarajevase e luftës*. Falënderimet e saj, për shtëpinë tonë botuese dhe për ata shqiptarë që kujdesen për vlera letrare dhe njerëzore, për ata shkrimtarë që i do dhe i kërkon bota, që janë institucione të kujtesës kombëtare, që ua kujtojnë gabimet shteteve dhe udhëheqësve të tyre, janë shumë të njerëzishme dhe janë shumë miqësore. Pas shumë fjalëve të saj për punën tonë, i kemi dërguar në fund këtë fjali: *Boshnjakët edhe mund ta harrojnë luftën, edhe ta harrojnë Sarajliqin, por ne s'do ta harrojmë kurrë luftën e Bosnjës në vargjet e Izetit; s'do ta harrojmë kurrë masakrën që i është bërë popullit të tij; s'do ta harrojmë kurrë fatin e përbashkët që kishim: ju vetëm atje, ne shqiptarët këndo.*

N. Sh. Armagedoni

4.99 €



PËRMBLEDHJA SARAJEVASE E LUFTËS



IZET SARAJLIQ

Përktheu: Salajdin Salihu
Shkroi parathënien: Tamara Sarajliq Slavniq



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Sapori Italiana” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811452771 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Sapori Italiana”, D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811452771, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Sapori Italiana” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811452771, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Erdem Hamdiu B.I. D.P.H. “Renne” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues 810927923 nrb. 70911930.

► Fatmir Ra. Aliu B.I. N.T.SH. “Eco Higjiene” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810905284 nrb. 70714736.

► Fal-Co Kosova” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810112409

► Fortesa Zenelaj shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII te Sh.M.Mjekësisë ne Gjakovë.

► Artan Qurdina shpall te pa vlefshme dëftesën e plot te Sh.F.M.U. "Mustafa Bakia" nga kl. I - IX ne Gjakovë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

